




Funded by
the European Union

COVID-19 si pretekst për lidhje të kontratave emergjente në prokurim publik

Qershor, 2021



Deklaratë mohuese:

Ky publikim është botuar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Demokraci Plus (D+) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Projekti “Kontribut në gjetjen e shkeljeve në prokurim publik të institucioneve në luftën kundër pandemisë COVID-19” i financuar nga BE, implementohet nga Demokraci Plus (D+)



**Funded by
the European Union**



**Democracy
Plus**

KY PUNIM ËSHTË PËRGATITUR NGA:

Agon Hysaj (Autor)

Arbelina Dedushaj (Kontribuese)

Egzona Kozhani (Kontribuese)



Vizitoni faqen tone në internet
www.dplus.org

**Mësoni më shumë rreth publikimeve
tona të fundit, lajmeve dhe
infografikave online.**



Find us on Facebook
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Find us on Twitter
[@democracyplus](https://twitter.com/democracyplus)



Find us on Youtube
[@democracyplus](https://www.youtube.com/democracyplus)

Zyrja jonë:

Rruga Tirana, Blloku C/4/1, Hyrja C, Kati VIII,
Nr. 83/84 Prishtinë, 10000
Kosovo

+383 (0) 38 749 288

info@dplus-ks.org

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet, ose transmetohet në çfarëdo forme ose me ndonjë mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, ose tjera, pa lejen e D+.

Falenderojmë Bashkimin Evropian për përkrahjen financiare të kësaj iniciative. Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.



**COVID-19 si pretekst
për lidhje të
kontratave
emergjente në**

Përmbajtja

Shkurtesat	6
Hyrje	7
Përmbledhje	8
Komuna e Vushtrisë - Studimi mbi ndikimin e pandemisë COVID-19	9
Komuna e Rahovecit – Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara gjatë kohës së pandemisë	12
Komuna e Prizrenit - Sensibilizimi i qytetarëve të Komunës së Prizrenit për parandalimin e COVID-19	13
Komuna e Gjakovës - Furnizim me material për masat Anti-COVID-19	16
ShSKUK - Shërbime funerale me COVID-19	18
Komuna e Drenasit - Furnizim me pako emergjente për nevojtarë - (611-20-1015-1-2-5)	20
Komuna e Drenasit - Furnizim me pako emergjente për nevojtarë (611-20-1367-1-2-5)	22
Komuna e Istogut – Furnizimi me pako ushqimore dhe higjienike për familje skamnore	23
Komuna e Prishtinës - Furnizimi me pako emergjente (ushqimore dhe higjienike) për familjet me kushte të vështirësuara ekonomike si rezultat i pandemisë COVID-19	25
Komuna e Vitisë - Furnizimi me material mbrojtës kundër COVID-19. Maska dhe dezinfektues	27
Rekomandime:	29

Shkurtesat

AK	Autoriteti Kontraktues
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
LPP	Ligji i Prokurimi Publik
OE	Operatori Ekonomik
RrUOPP	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik
ShSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës

Hyrje

Pranvera e vitit 2020 që solli edhe pandeminë COVID-19, shënoi një epokë dhe sfidë të re edhe për Kosovën dhe institucionet e saja në të gjitha drejtimet. Papritmas lindi një nevojë që institucionet të sigurojnë material mbrojtës për ta luftuar pandeminë e njëkohësisht u shtrua nevoja që të ndihmohen familjet në nevojë me pako ushqimore si pasojë e mbylljes pothuajse totale të vendit. Ligji për Prokurim Publik (LPP) në rast të emergjencave ekstreme parasheh mundësinë e përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë apo siç njihet në publik, procedura emergjente. Përdorimi i kësaj procedure në fillim të çfarëdo situatë të krijuar emergjente është më së e drejtë, por pandemia si e tillë nuk gëzon më epitetin e emergjencës ekstreme, pasi është e pranishme për më shumë se një vit. Megjithatë, institucionet kanë vazhduar të përdorin procedurën emergjente edhe gjatë këtyre muajve të fundit, edhe pse përgjigja ndaj pandemisë nuk është e njëjtë si në fillimet e saja.

Gjatë hulumtimit të çmimeve të produkteve të blera me kontrata të negociuara dhe duke i krahasuar me procedurat e hapura, Demokraci Plus ka vërejtur dallime drastike në çmime.

Përveç kësaj, përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë nuk e ka arritur qëllimin e saj, pasi në pjesën më të madhe të tenderëve nuk ka pasur negociata, por është nënshkruar kontrata me çmimin e njëjtë të ofruar nga kontraktori, ndërsa në vetëm disa raste janë zvogëluar çmimet pas negociatave.

Në këtë raport janë analizuar disa tenderë që lidhen me blerjen e produkteve për mbrojtjen nga pandemia, siç janë tenderët për maska, teste dhe pako ushqimore.

Përmbledhje

Në këtë raport janë analizuar dhjetë tenderë me të cilat janë shpërblyer operatorët ekonomikë gjatë kohës së pandemisë COVID-19. Shfrytëzimi i procedurës së negocimit në lidhjen e këtyre kontratave ka sjellë me vete shkelje të njëpasnjëshme të legjislacionit të prokurimit publik. Autoritetet kontraktuese duke ftuar një numër shumë të vogël operatorësh kanë ndikuar që në mënyrë enorme të rriten çmimet e ofertave, duke dëmtuar kështu buxhetin e tyre dhe konkurrencën.

Pavarësisht arsytimit të emergjencës për të blerë apo për të marrë ndonjë shërbim nga operatorët ekonomikë, për shkak të situatës së krijuar, shpesh herë është iniciuar si procedurë edhe pa qenë një nevojë e tillë. Njëra prej qëllimeve kryesore të përdorimit të kësaj procedure është ulja e çmimit përmes negocimit. Mirëpo, këtë gjë autoritetet kontraktuese nuk e kanë shfrytëzuar siç duhet, meqë vetëm disa prej tyre e kanë kërkuar uljen e çmimit të ofertës nga operatorët ekonomikë. E edhe në rastet kur kishte pasur negociata, çmimi ishte ulur shumë pak.

Dy komuna ajo e Vushtrrisë dhe e Rahovecit kanë lidhur kontratë publike për të kryer një studim për ndikimin e pandemisë në ekonominë e komunës. Komuna e Vushtrrisë kishte lidhur kontratë në vlerë prej 140 mijë eurosh, por që nuk është dashur të zbatohet pasi kontrata nuk është nënshkruar edhe nga kryetari i komunës. Sipas LPP-së, kontratat me vlerë të madhe duhet të nënshkruhen nga kryetari i komunës. Kontrata edhe pse është zbatuar në tërësi, është e paligjshme. Nga ana tjetër, Komuna e Rahovecit një studim të ngjashëm, por me më pak kërkesa e kishte kryer për 12,500 euro, por gjatë rrugës e deri në implementim të kontratës kishte pasur parregullsi.

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka tejkaluar limitin prej +30% të kontratës kornizë dhe ka vazhduar të bëjë pagesa për operatorin ekonomik, ndërsa ligji thotë që kontrata ndërpritet automatikisht nëse tejkalohet ky limit. Për më tepër ShSKUK ka paguar çmime që nuk kanë qenë të parapara në kontratë.

Një kontratë të një natyre pak më ndryshe kishte lidhur edhe Komuna e Prizrenit, e cila kishte paguar 20,378.60 euro për t'i sensibilizuar prizrenasit me masat për parandalim të virusit. Komuna ka paguar për disa produkte, të cilat kanë qenë të gatshme nga Qeveria e Kosovës.

Një operator ekonomik ishte ftuar tri herë radhazi për të ofertuar dhe ishte shpërblyer me kontratë nga Komuna e Drenasit. I njëjti operator ekonomik për njërin nga tenderët kishte hequr një pozicion duke bërë që çmimi total të ulet dhe të shpallet fitues. Mirëpo, ky fakt nuk ishte evidentuar askund, me ç'rast kjo kontratë si e tillë është e kundërligjshme.

Komuna e Gjakovës ka ftuar për të ofertuar një kompani e cilat merret me konsulencë, ndërsa kompania tjetër në konsorcium nuk ka licencë për produkte medicinale, e cila ishte kërkuar në dosje të tenderit.

Komuna e Prishtinës ka ndarë një tender në pesë lloje të njëjta, mirëpo ka ftuar vetëm gjashtë kompani të ofertojnë, të cilat kanë pasur të drejtë të fitojnë vetëm një llot. Si rezultat i këtij veprimi komuna ka lidhur kontratën në total për 23,660 euro më shtrenjtë.

Komuna e Vushtrisë - Studimi mbi ndikimin e pandemisë COVID-19

Nga të gjitha komunat e Kosovës, vetëm ajo e Vushtrisë ka tentuar që të bëjë një studim të mirëfilltë për ta hulumtuar ndikimin e pandemisë. Pasi që studimi është bërë gjatë periudhës shtator-dhjetor 2020 dhe nuk është ditur sa do të zgjasë pandemia, atëherë me siguri komunës do t'i duhet edhe një studim tjetër në fund të pandemisë për ta parë kështu ndikimin përfundimtar të saj.

Komuna për këtë qëllim nënshkroi kontratën për një shumë prej 140,000 euro. Kontrata u lidh me kompaninë M Holding, e cila ishte ftuar për negociim së bashku me dy kompani tjera, por këto të fundit kanë ofertuar me çmim më të shtrenjtë, gjë që e kishte bërë M Holding fituese të tenderit. Për dallim prej shumë institucioneve tjera, ftesa për tre ofertuesit është veprim i duhur, mirëpo për hir të rritjes së konkurrencës, komuna është dashur të zgjerojë listën dhe të ftojë kompani tjera që janë të specializuara për të tilla studime. Pavarësisht faktit që tenderi ka pasur të bëjë me pandeminë, ky studim nuk është dashur të bëhet me negociim pasi studimi nuk ka qenë çështje emergjente, siç ka qenë furnizimi me maska dhe produkte tjera që mbrojnë nga infektimi me virusin Sars CoV-2.

Nr.	Tenderuesi	Çmimi
1	ISD L.L.C.	163,450 euro
2	Kolegji i Menaxhimit Internacional Globus	163,600 euro
3	M Holding SH.P.K.	148,751.79 euro

TABELA 1 – Çmimet e dhëna nga operatorët ekonomikë të ftuar për negociim

Komuna edhe pse ka ftuar tri kompani që të ofertojnë, në negociata ka ftuar vetëm kompaninë M Holding. Komisioni i Vlerësimit e cilësoi si të papërgjegjshme ofertën e Kolegjit Globus, ndërsa si të pasuksesshme ofertën e ISD. Pasi që ISD ka plotësuar kriteret e kërkuara, e njëjta është dashur që të ftohet në negociata, pa dashur që të paragjykohet se a do të ulë çmimi i ofertës së saj, siç ka ndodhur me ofertën e fituesit, i cili gjatë negociatave ka ulur çmimin nga 148,751.79 në 140,000 euro. Gjithashtu kërkesë e komunës ka qenë që kontrata të përfundojë më 20.12.2020, ku kompania është përgjigjur që të gjitha punët do të përfundojnë më 20.11.2020, pra një muaj para kohës.

Përfundimisht kontrata është nënshkruar me afat të përfundimit të të gjitha shërbimeve, më datë 30 nëntor 2020. Megjithatë, kontrata ka përfunduar më 22 dhjetor 2020, në të cilën ditë M Holding ka dorëzuar raportin “Vlerësimi i ndikimit socio-ekonomik të pandemisë COVID-19 në Komunën e Vushtrisë”. Pra realizimi i kontratës është vonuar për 22 ditë. Nga dokumentet e pranuar nga komuna, D+ nuk ka vërejtur që është aplikuar ndëshkim për vonesë. Sipas nenit 13 të Kushteve të Përgjithshme të kontratës, komuna mundet që t'ia ndalojë 0.25% në ditë të vlerës së kontratës deri në një maksimum prej 10% të vlerës totale të kontratës. Në të kaluarën D+ ka vërejtur që pikërisht Komuna e Vushtrisë e ka përdorur këtë mundësi në një kontratë tjetër. Po ta bënte të njëjtën gjë edhe në këtë kontratë, komuna do t'ia paguante kompanisë M Holding 7,700 euro më pak:

$$22 \text{ ditë} * 0.25 = 5.5\%$$

$$140,000 * 5.5\% = 7,700 \text{ euro}$$

Sipas nenit 19 dhe 26 të LPP-së, kontratat e shërbimeve me vlerë më të lartë se 125,000 euro duhet të nënshkruhen edhe nga Zyrtari Kryesor Administrativ, që për komuna nënkupton kryetarin e komunës. Mirëpo, kontrata me M Holding është nënshkruar vetëm nga Zyrtari

Përgjegjës për Prokurim. Neni 26.2 i LPP-së¹ thotë shprehimisht që kontratat që nuk nënshkruhen nga ZKA janë të pazbatueshme. Kjo nënkupton që Komuna ka zbatuar një kontratë e cila ligjërisht ka qenë e pazbatueshme.

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Hyda Dallku
Pozita:	Zyrtar përgjegjës për prokurim
Nënshkrimi:	
Data:	07.09.2020
Vula:	

Për Kontraktuesin: "M Holding" sh.p.k.

Emri:	Muhamet Spahiu
Pozita:	Përfaqësues i Kryesit të Shërbimeve "M Holding" sh.p.k.
Nënshkrimi:	
Data:	07.09.2020
Vula:	

Figura 1: Mungesa e nënshkrimit të kryetarit të Komunës së Vushtrrisë në kontratën me M Holding

Sa i përket zbatimit të kontratës, studimi për të cilin është kontraktues M Holding ishte planifikuar të kryhej në tri faza:

- Faza 1 – hartimi i panit për identifikimin e operatorëve ekonomikë, ekonomive familjare dhe të punësuarve joformalë dhe sezonalë në komunë dhe kategorizimin e tyre në grupe specifike për mbështetje të drejtpërdrejtë
- Faza 2 – identifikimi i dëmeve të shkaktuara si pasojë e pandemisë COVID-19 tek operatorët ekonomikë, ekonomitë familjare dhe të punësuarit joformalë dhe sezonalë në komunë, si dhe
- Faza 3 – funksionalizimi i Grupit Lokal të Veprimit (GLV) në Komunën e Vushtrrisë dhe hartimi i 10 projekt-propozimeve.

Fillimisht pas nënshkrimit të kontratës kompania ka qenë e obliguar që të dorëzojë metodologjinë e punës dhe planin e veprimit. Sipas metodologjisë është dashur të përzgjidhet mostra e anketimit të familjeve dhe bizneseve përmes anketuesve në terren. Vlen të theksohet se nuk dihet sa kanë qenë anketues në terren, pasi në konkursin që kompania kishte hapur për t'i rekrutuar të njëjtit, nuk është caktuar se sa të tillë po kërkojnë për hulumtimin në fjalë. Mostrën që kompania kishte përzgjedhur kishte qenë sipas metodës së rastit me ç'rast janë përzgjedhur 458 ekonomi familjare dhe 184 biznese.

Në fazën e parë të projektit, i cili ka kushtuar 47,200 euro, M Holding ka mbajtur tri takime me tri drejtorë, të cilat takime janë mbajtur në nëntor dhe dhjetor, por që sipas planit të

¹ Ligji për Prokurimin Publik. 2011.

<https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Ligjet/shq/LPP%20i%20konsoliduar.doc>

veprimit është dashur të mbahen deri më 25 shtator 2020. Përveç kësaj, kompania në fjalë ka mbajtur edhe një tryezë diskutimi me biznese të Komunës së Vushtrrisë. Në raportin që kanë nxjerrë nga ky takim i përbashkët, nuk ceket as numri i bizneseve që kanë marrë pjesë, vetëm qëllimi i tryezës dhe rekomandimet e dala.

Faza e dytë është paguar për një shumë të ngjashme me fazën e parë, me 46 mijë euro. Në këtë fazë është përshkruar gjendja socio-ekonomike e popullsisë së Vushtrrisë, ku shumica e të dhënave janë nxjerrë nga ASK-ja dhe nga komuna. Në këtë fazë janë listuar edhe përgjigjet e të anketuarve për çdo pyetje që u është parashtruar familjeve dhe bizneseve.

Po ashtu, te Plani për Rimëkëmbje Ekonomike i komunës është futur edhe një moratorium katërvjeçar që ndalon buxhetin komunal të shpenzojë për asfaltim të rrugëve lokale. Por një gjë e tillë nuk është përfillur. Kjo komunë 3 muaj pas pranimit të raportit, më 29 mars 2021, ka publikuar një njoftim për kontratë që ka të bëjë pikërisht me asfaltim i ndarë në tri lloje, nën emërtimin “Ndërtimi i rrugës së rendit të katërt me zhavorr në fshatin Skoqne, asfaltimi i rrugës në fshatin Taraxhë - Bruznik dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Samadrexhë - Dumnicë”. Vlera e parashikuar e këtij tenderi arrin rreth 200 mijë euro. Një tjetër tender është ai për ndërtimin e rrugës Galip Badivuku me vlerë të tenderit rreth 43,000 euro. Tenderi i parë është bashkëfinancim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, ndërsa i dyti është financim i komunës. Në të dy raste buxheti komunal do të shpenzohet, ndërsa komuna ka votuar propozimin që mos të ketë asfaltim të rrugëve lokale në periudhën katër vjeçare. Komuna ka publikuar edhe tenderë tjerë që janë bashkëfinancim. Siç duket moratoriumi katërvjeçar nuk ka gjasa që të zbatohet, prandaj vihet në pyetje serioziteti i komunës për të zbatuar rekomandimet e dala në raportin e vlerësimit të ndikimit të pandemisë.

Për fazën e tretë, M Holding është paguar nga komuna 46,190 euro. Në këtë fazë, kompania fituese ka pasur për obligim ta funksionalizojë Grupin Lokal të Veprimit (GLV) të kësaj komune dhe hartimin e 10 projekt-propozimeve.

Sipas pikës 4.4 të planit të aktiviteteve, M Holding ka cekur se do të bëhet përzgjedhja e trupit menaxhues të GLV-së, i cili do t'i përfaqësojë interesat e grupeve të ndryshme publike, por nuk është bërë një gjë e tillë dhe nuk figuron në raport. Në këtë pikë vetëm janë listuar disa formularë për zgjedhjen e bordit, deklaratë e votimit për zgjedhje të bordit, lista e pjesëmarrësve, etj.

Përveç kësaj, në pikën 4.5 është cekur se popullata rurale do të njoftohet me aktivitetet e GLV-së përmes ueb-faqes Vicianarural.com, mirëpo e njëjta nuk është funksionale. E njëjta është aktive vetëm si një shabllon, mirëpo nuk përmban asnjë informacion². Megjithatë edhe pse këto dy aktivitete nuk janë përfunduar, kompania është paguar e gjithashtu në raportin e pranimit thuhet se të gjitha aktivitetet kanë përfunduar.

Gjithashtu, M Holding ka cekur se do të mbajë takime për ngritjen e kapaciteteve për përgatitjen projekt-propozimeve, por askund nuk është cekur sa trajnime janë mbajtur, ku dhe si janë mbajtur, numrin e pjesëmarrësve në trajnime, etj.

Si përfundim, edhe pse komuna ka ftuar tri kompani për të ofertuar, mosnënshkrimi i kontratës nga kryetari i kësaj komune e bën kontratën të pazbatueshme sipas LPP-së, e gjithashtu pagesa për disa aktivitete që nuk janë përfunduar nga M Holding tregon se menaxhimi i kontratës nuk është bërë siç duhet.

² Për të vizituar ueb-faqen e Vicianarural, vizitoni: <http://vicianarural.com/> (qasur më 20 prill 2020).

Komuna e Rahovecit – Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara gjatë kohës së pandemisë

Për një studim të ngjashëm edhe Komuna e Rahovecit ka nënshkruar kontratë për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara gjatë kohës së pandemisë që janë krijuar si rezultat i koronavirusit – COVID-19. E njëjta komunë, në qershor, vendosi ta bëjë studimin e vlerësimit të dëmit. Pra, në kohën kur nuk dihej ende se sa do të zgjasë pandemia, gjë që dëshmon fakti që ende jemi duke u ballafaquar me të, ky autoritet kontraktues kishte ftuar vetëm një konsorcium që të negociojë për kryerjen e një shërbimi të tillë. Komuna për të zhvilluar këtë aktivitet prokurimi ka përdorur nenin 35.2.1 (iii) të LPP-së i cili ka të bëjë me emergjenca ekstreme. Kjo i mundëson autoriteteve kontraktuese që të nënshkruajnë kontratën edhe në rast se ka ankesa. Komuna ka dërguar ftesën për ofertim te dy kompani, te Integra Consulting dhe Instituti për Ndërmarrësi dhe Biznes të Vogël (IESB) të cilat kanë ofertuar si konsorcium me çmim 12,500 euro, mirëpo pas negociatave, çmimi ishte zbritur për 200 euro, në 12,300. Ftesa për negociata dhe bindja për ta ulur çmimin janë veprime pozitive të komunës, duke marrë parasysh që shumë autoritete kontraktuese nuk i kanë ftuar fare për negociata operatorët ekonomikë.

Në këtë tender janë disa probleme madhore. Fillimisht, duke ftuar vetëm një operator ekonomik (në këtë rast grup operatorësh), komuna e ka dëmtuar konkurrencën. LPP-ja e ndalon dëmtimin e konkurrencës edhe gjatë zhvillimit të procedurave me negociim pa publikimin e njoftimit për kontratë. Në arsyetimin e procedurës së negociuar, komuna kishte cekur arsyen se konsorciumi fitues e nje mirë terrenin e Rahovecit, pasi dy operatorët që janë pjesë e tij janë nga kjo komunë. Autoriteti kontraktues ka listuar edhe disa arsye tjera, si urgjencën për të kryer një studim të tillë, faktin që konsorciumi i ftuar është duke bërë edhe studime të tjera të ngjashme etj., mirëpo arsye të tilla nuk e arsyetojnë shkeljen e konkurrencës dhe mospërdorimin e procedurës së hapur.

Arsye tjetër është se raporti me vlerësimet e dëmit do të dërgohet në Qeverinë e Kosovës në kohën e rishikimit të buxhetit. Mirëpo, Qeveria e Kosovës ka aprovuar rishikimin e Buxhetit të Kosovës për vitin 2020, më 17 qershor 2020³, ndërsa komuna ka lidhur kontratën me konsorciumin më 25 qershor 2020, ndërsa raporti për vlerësimin e dëmeve është dorëzuar te komuna më 24 korrik 2020. Kjo tregon që arsyetimi i përdorur nga komuna nuk qëndron dhe asnjë rekomandim që ka dalë nga raporti nuk ka mundur të përfshihet në buxhetin e rishikuar.

Problemi i dytë është që komuna ka përcaktuar në fillim që kompanitë duhet të ofertojnë si konsorcium. Kjo lë të kuptohet që kompanitë e kanë ditur paraprakisht që ky autoritet kontraktues do ta bëjë një studim të tillë dhe rrjedhimisht i ka ftuar si një konsorcium. Mirëpo, sipas LPP-së, themelimi i konsorciumeve është vullnet i lirë i kompanive e jo imponim i komunës. Përmes këtij veprimi komuna ka shkelur nenin 71 të LPP-së.

Shkelje tjetër e komunës është caktimi i menaxherit të kontratës. Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, menaxheri i kontratës duhet të emërohet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës. Menaxheri pastaj përgatit planin për menaxhimin e kontratës që nënshkruhet edhe nga operatori ekonomik. Mirëpo, vendimi për caktimin e menaxherit të kontratës është nënshkruar nga kryetari i komunës më 2 shtator 2020. Përkundër kësaj, menaxheri i kontratës ka aprovuar raportin e vlerësimit të dëmit më 24 korrik 2020 e kjo

³ Vendimi i Qeverisë së Kosovës 01/06.

<https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/06/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-6-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf>

nënkupton që menaxheri i kontratës ka marrë veprime pa qenë i emëruar nga kryetari i kësaj komune.

Një shkëlqje tjetër është edhe hartimi i situacionit të pranimit përfundimtar i cili është hartuar nga operatori ekonomik. Ky dokument është dashur të hartohet nga menaxheri i kontratës, sipas nenit 61 të RrUOPP, pasi autoriteti kontraktues është porositës i shërbimit e jo e kundërta. Është e papranueshme që operatori ekonomik të hartojë raport të pranimit e autoriteti kontraktues vetëm ta nënshkruajë atë.

Në raportin 24 faqesh që konsorciumi ia ka dorëzuar komunës, ishin prezantuar të dhëna bazuar në mostrën që kishin përzgjedhur me biznese dhe ekonomi familjare, ku për studim ishin marrë 104 biznese dhe 63 ekonomi familjare⁴, anketa të cilat janë kryer online, por edhe me takime të drejtpërdrejta.

Duhet përmendur, se gjatë analizimit të vlerësimit të dëmeve që është bërë, nuk është treguar se si ka ardhur deri të rezultatet e paraqitura që kanë të bëjnë me vlerësimin e humbjeve. Pra, në raportin e Integra & IESB, janë pasqyruar humbjet totale në ekonomi, humbjet për biznese, punësim i papaguar, taksat dhe tatimet dhe humbjet tjera, por nuk figuron asnjë tabelë se si ka qenë gjendja deri në momentin e fillimit të pandemisë dhe më saktë se si është llogaritur kjo humbje.

Pjesa e intervistimit të ekonomive familjare nuk është shtjelluar në asnjë pjesë të raportit, përveç në dy tri pjesë ku përmendet së bashku me sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë. Këtë dy sektorë nuk janë sinonim i ekonomive familjare, gjë që as në këtë pjesë puna nuk është kryer siç duhet.

Nga 24 faqe raport, deri në 11 faqe e gjysmë është shkruar hyrja, qëllimi i studimit dhe metodologjia, ndërsa pjesa tjetër, 12 faqe e gjysmë janë paraqitur rezultatet e arritura.

Duke marrë parasysh të dhënat më lart, komuna nuk ka arritur të tregojë saktë dëmet e shkaktuara, e për më tepër që pandemia ende është duke vazhduar edhe dëmet janë llogaritur vetëm për periudhën mars 2020 – korrik 2020.

Komuna duhet të sigurohet që mos t'i përsërisë gabimet në aktivitetet e ardhshme të prokurimit dhe të evitohet përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë në mënyrë që të rrisë konkurrencën dhe të rrisë gjasat që të marrë çmime më të ulëta.

Komuna e Prizrenit - Sensibilizimi i qytetarëve të Komunës së Prizrenit për parandalimin e COVID-19

Për dallim nga komunat e Vushtrrisë dhe Rahovecit, Komuna e Prizrenit kishte vendosur që qytetarët e saj t'i njoftojë me masat për parandalim të koronavirusit. Pavarësisht, udhëzimeve të vazhdueshme që ka bërë Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, kjo komunë kishte vendosur që në maj, pas dy muajsh pandemie, të hapë një tender përmes negocimit, ku ftoi tre operatorë ekonomikë për të dorëzuar oferta. Sidoqoftë, vetëm dy OE ofertuan.

Ftesa i janë dërguar CONS ENG, Office 1 Kosova dhe Selmans Network. Të tri këto kompani nuk kanë aktivitet primar dizajnimin e infografikave, prodhimin e videove apo ndërtimin e ueb-faqeve. CONS ENG aktivitet primar e ka tregtinë me kompjuterë, Office 1 Kosova merret

⁴ Është përdorur metoda e rastit.

me material për zyrë, ndërsa Selmans Network merret me pastrim të ndërtesave, edhe pse si aktivitet sekondar e ka të listuar prodhimin e reklamave. Sidoqoftë, Selmans Network nuk ka dorëzuar ofertë, por vetëm Office 1 Kosova me çmim 21,918.50 euro dhe CONS ENG me çmim 20,378.60 euro, e cila edhe ka fituar kontratën.

Komuna ka ftuar të dy kompanitë për të negociuar, por çmimi nuk kishte ndryshuar, pra kontrata ishte nënshkruar me po atë çmim të ofertës në shumën prej 20,378.60 euro.

Sipas kontratës, CONS ENG është dashur të dërgojë një numër infografikash, video me animacione, përgatitjen e manualeve për masat e ndërmarra nga qeveria, një reklamë për TV dhe angazhimin e disa praktikantëve që i sensibilizon qytetarët me masat kundër COVID-19.

Nr	Lloji i shërbimit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Totali
1	Infografika me voice over dhe animacion, përpilimi i materialeve për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 (në tri gjuhë - shqipe, turke, serbe/boshnjake).	5*3	15	50 €	750 €
2	Infografikë me voice over dhe animacion, realizimi (në tri gjuhë - shqipe, turke, serbe/boshnjake).	5*3	15	100 €	1,500 €
3	Përgatitja dhe përpilimi i infografikave për shtyp dhe postime në FB (në tri gjuhë - shqipe, turke, serbe/boshnjake).	5*3	15	50 €	750 €
4	Dizajn i infografikave për shtyp dhe postime në FB (në tri gjuhë - shqipe, turke, serbe/boshnjake).	5*3	15	20 €	300 €
5	Dizajnim dhe programim i ueb-faqes në tri gjuhë dhe organizimi i përmbajtjes dhe mirëmbajtja për gjashtë (6) muaj.	1	1	1,250 €	1,250 €
6	Përkthimi i materialeve të ueb-faqes në dy gjuhë, organizimi dhe mirëmbajtja.	1	2	500 €	1,000 €
7	Përgatitja dhe përpilimi i manualeve për masat (12-20 faqe) për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 (në tri gjuhë - shqipe, turke, serbe/boshnjake).	1*3	3	200 €	600 €
8	Dizajn i manualeve për masat 12-20 faqe (në tri gjuhë - shqipe, turke, serbe/boshnjake).	1*3	3	150 €	450 €
9	Dizajn i shenjzimeve për biznese (në tri gjuhë - shqipe, turke, serbe/boshnjake).	Lloje	20	40 €	800 €
10	TV Reklamë senzibilizuese.	1*3	3	370 €	1,110 €

11	Ofrimi i shërbimeve psikologjike nga praktikantët, përmes thirrjeve telefonike. Duhet të angazhohen gjashtë (6) praktikantë për dy muaj. Kjo pagesë i bëhet vullnetarëve të paraqitur në Komunën e Prizrenit, si pagë për jetesë dhe shpenzime të shërbimit.	Person a(6*2)	12	100 €	1,200 €
12	Ofrimi i shërbimeve dhe informimi i qytetarëve nga praktikantët, përmes thirrjeve telefonike dhe shërbimeve të tjera online (nga distanca). Funkcionalizimi i Qendrës Operative Lokale.	Person a (7*3)	21	360 €	7,560 €

TABELA 2 – Çmimet sipas kontratës

Në kontratë, e cila është nënshkruar në maj, nuk ceket se ku do të publikohen dhe cili do të jetë plani i shpërndarjes së këtyre materialeve sensibilizuese. Mirëpo të gjitha këto materiale janë publikuar në ueb-faqen e zhvilluar, covidpz.com

Në pozicionin nr. 5 dhe 6 kërkohet dizajni i një ueb-faqeje për qëllim të parandalimit të COVID-19 dhe përkthimi i saj në dy gjuhët tjera⁵. Për këtë shërbim komuna ka paguar 1,250 euro, ndërsa çmimi i tregut është rreth 500-700 euro. Këto para që ka shpenzuar komuna e kanë humbur efektin e saj që në fillim pasi ueb-faqja nuk është përditësuar fare. Publikimi i fundit i ndonjë lajmi është në muajin prill 2020. Përderisa masat për luftimin e pandemisë kanë ndryshuar disa herë që nga ajo kohë, ueb-faqja nuk është përditësuar për të përfshirë këto ndryshime.

Nga ana tjetër, për tri pozicione është dorëzuar vetëm një produkt:

- Pozicioni 7 - përgatitja dhe përpilimi i manualeve për masat (12-20 faqe) për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 (në tri gjuhë - shqipe, turke, serbe/boshnjake);
- Pozicioni 8 - dizajni i manualeve për masat 12-20 faqe (në tri gjuhë - shqipe, turke, serbe/boshnjake), si dhe
- Pozicioni 9 - dizajni i shenjëzimeve për biznese (në tri gjuhë - shqipe, turke, serbe/boshnjake)

Pra, për tri këto pozicione që janë paguar 1,850 euro është dorëzuar vetëm një manual⁶ për thjeshtëzimin e procedurave për masat e ndërmarra nga qeveria përmes Pakos Fiskale Emergjente. Mirëpo, të gjitha këto udhëzime, për secilën masë veç e veç, kanë qenë të ofruara nga Qeveria e Kosovës⁷. P.sh. për masën 7⁸ që ka të bëjë me pagesën shtesë prej 100 euro për muajt mars dhe prill 2020, udhëzimet janë të ngjashme me ato që i ka bërë implementuesi i kësaj kontrate. Pra, aty ceket se kush përfiton, çka përfiton dhe si të aplikohet. Ngjashëm, edhe CONS ENG e kishte bërë të njëjtën gjë, vetëm me fjali të modifikuar dhe me renditje të fjalive ndryshe nga ato të qeverisë.

⁵ Informatat për COVID-19. Komuna e Prizrenit. E qasshme në: <https://covidpz.com/>

⁶ Pakoja Fiskale Emergjente. Komuna e Prizrenit. E qasshme në: https://covidpz.com/wp-content/uploads/2020/04/PFE_PZ-compressed.pdf

⁷ Masat ekonomike gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Ministria e Financave dhe Transfereve. Të qasshme në: <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,170>

⁸ Masa 7 e Pakos Fiskale Emergjente. Ministria e Financave dhe Transfereve. E qasshme në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/57234F05-BFA3-4DFF-85B0-129DDC575AE9.pdf>

Komuna ka mundur të përdorë të gjithë materialin që ka qenë i përgatitur nga Qeveria e Kosovës dhe nuk ka pasur nevojë që të njëjtën gjë ta bëjë dy herë e në këtë rast ta dëmtojë buxhetin e saj për 1,850 euro. Nga kjo kuptohet që nuk është bërë paraprakisht një hulumtim i tregut apo për të parë se a mund t'i marrë të gatshme materialet nga institucionet tjera.

Në pozicionin 10 është kërkuar që të prodhohet një reklamë sensibilizuese. D+ ka kërkuar nga komuna informacione se ku është publikuar TV reklama, e cila është dërguar vetëm në gjuhën shqipe, mirëpo komuna nuk është përgjigjur.

Të dhënat e mësipërme tregojnë që kjo kontratë ka disa probleme duke filluar nga vendimi për të ftuar në negociata kompani që nuk kanë aktivitet primar prodhimin e këtyre materialeve, porositja e disa produkteve që nuk kanë arritur efektin e duhur (disa prej tyre që kanë mundur të merren të gatshme nga Qeveria e Kosovës), e deri të realizimi jo adekuat i produkteve të porositura.

Komuna e Gjakovës - Furnizim me material për masat Anti-COVID-19

Një prej kontratave që Komuna e Gjakovës kishte lidhur gjatë kohës që po përballemi me pandeminë është edhe "Furnizim me material për masat Anti-COVID-19", e cila i ka kushtuar këtij institucioni 175,702.80 euro. Komuna, të njëjtin tender e kishte ndarë në dy lloje sipas kërkesave të drejtorive që i kishin kërkuar këto materiale, pra lloji 1 për Drejtorinë e Arsimit, ndërsa lloji 2 për Drejtorinë e Administratës.

Komuna përdori procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, edhe pse kontrata është lidhur në nëntor 2020. Në këtë periudhë pandemia nuk mund të konsiderohet më emergjencë dhe komuna është dashur që të përdorë procedurën e hapur, në mënyrë që të rrisë konkurrencën. Komuna ka ftuar vetëm dy kompani që të dorëzojnë ofertë, Made-Kos e cila është kompani farmaceutike dhe konsociumin "Alb Consulting & Genius Kosova". Përderisa Genius Kosova merret me shitje të produkteve medicinale, Alb Consulting biznesin e zhvillon në sektorin e teknologjisë informative. Fitues i të dy llojeve u shpall konsorciumi Alb Consulting & Genius Kosova me çmim 82,946.50 euro për lloji 1 dhe 91,892.35 për lloji 2.

Para se të shpallet fitues një OE, i kërkohet që të dorëzojë vërtetimin se nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve. Konsorciumi ka dorëzuar dy vërtetime, një për Alb Consulting dhe një për kompaninë Fresh-Co Sh.P.K., e cila nuk është ofertues në këtë tender. Vërtetimi është dashur të dorëzohet për kompaninë Genius Kosova, ku siç duket komisioni i vlerësimit nuk e kanë verifikuar fare këtë fakt. Prandaj, mosdorëzimi i këtij vërtetimi nga ana e Genius Kosova e bën të papërgjegjshme ofertën e konsorciumit.

Një nga kërkesat e dosjes së tenderit ka qenë që OE duhet të ketë licencë si qarkullues me shumicë për produkte mjekësore e cila lëshohet nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM). Anëtarin e konsorciumit, Genius Kosova ka dorëzuar licencë për shitje me shumicë të pajisjeve medicinale, ndërsa kërkesa ka qenë për produkte mjekësore. Ofertuesi tjetër në këtë tender, Made-Kos e ka dorëzuar licencë që përfshin produktet dhe pajisjet medicinale. Kjo konfirmohet nga lista e kompanive të licencuara që gjendet në ueb-faqen e AKPPM, ku Genius Kosova është i licencuar vetëm për tregti me pajisje medicinale e jo për produkte mjekësore⁹, ndërsa në këtë tender janë kërkuar produkte mjekësore e jo

⁹ Depot e licencuara për pajisje. Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale.
<https://akppmadmin.com/Medias/Depot%20me%20pajisje%20medicinale%2003.08.2020.pdf>

pajisje medicinale. Mosplotësimi i kësaj kërkesë e bën të papërgjegjshëm këtë konsorcium, me ç'rast komuna nuk është dashur ta nënshkruajë këtë kontratë.

Gabim tjetër i komunës është që në dosje të tenderit dhe në paramasën për llotin 2, përveç sasive ka publikuar edhe çmimet e parapara për secilin produkt. Me këtë veprim, komuna i ka treguar kompanive se çfarë çmimi pret për secilin produkt. Për llot 1, komuna ka paraparë që kontrata do t'i kushtojë 83,490.50 euro, ndërsa oferta e Alb Consulting & Genius Kosova është 82,946.50 euro, pra një diferencë prej vetëm 544 euro. Për llot 2 komuna ka paraparë që kontrata do t'i kushtojë 92,212.35 euro, ndërsa oferta e konsorciumit është 91,892.35, me një dallim prej 320 euro. Publikimi i çmimeve të parashikuara është veprim i gabuar nga ana e komunës, pasi që sipas RrUOPP është OE ai që duhet ta plotësojë listën e çmimeve.

Kur është bërë ndarja në lloje si duket komuna nuk ka verifikuar produktet që janë kërkuar. Si rezultat ka ndodhur që produkti i njëjtë të gjendet në dy lloje dhe kjo i ka mundësuar konsorciumit fitues që për produktin e njëjtë të japë çmime të ndryshme.

P.sh.: në të dy llojet janë kërkuar maska të thjeshta, të cilat janë emëruar ndryshe për njërin e ndryshe për tjetrin llot. Kur është bërë furnizimi, konsorciumi fitues ka sjellur të njëjtën maskë për dy llojet, për të cilat komuna ka paguar çmim të ndryshëm. Drejtoria e Arsimit kishte kërkuar maskë treshtresore, për të cilën konsorciumi kishte ofertuar me 0.20 euro, ndërsa për llotin 2, ku njësi e kërkesës është Drejtoria e Administratës, kishte ofertuar me 0.35 euro për një maskë që në paramasë është emërtuar si maskë kirurgjike, mirëpo që në realitet është maskë e njëjtë si ajo në llot 1. D+ ka pranuar dëshmi nga menaxheri i kontratës e ku në bazë të fotografive dëshmohet se për të dy llojet është dërguar produkti i njëjtë. Nga ana tjetër, çmimet e tregut në këtë periudhë kohore, gjatë nëntorit, pikërisht për tenderët me procedurë të negociuar kanë qenë 0.13 euro për një maskë, ndërsa për tenderët me procedurë të hapur, çmimi ka qenë akoma më i lirë, ku një maskë është blerë vetëm për 0.10 euro. Pra, komuna ka paguar dy (2) deri tre (3) herë më shtrenjtë se çmimet e tregut, e po ta përdorte procedurën e hapur gjasat do të shtoheshin që të ofertonin më shumë kompani dhe do të ullej çmimi. Sidoqoftë, edhe pse është përdorur procedura emergjente, neni 50.4 i RrUOPP shprehimisht e thotë se çmimi i kontraktuar nuk duhet të jetë më i lartë se çmimi i tregut. Në këtë rast komuna përveç se ka shkelur ligjin, i ka shkaktuar dëm edhe buxhetit të saj për 22,026.12 euro.

Përshkrimi	Sasia	Çmimi	Totali (euro)	Çmimi i tregut	Totali (euro)
Llot 1 – Maska kirurgjikale	86421 maska	0.35	30,247.35	0.13	11,234.73
Llot 2 – Maska treshtresore	43050 maska	0.20	8,610	0.13	5,596.50
			38,857.35		16,831.23

TABELA 3 – Krahasimi i çmimeve në mes kontratës së Komunës së Gjakovës dhe kontratave tjera

Shënim: Për llot 2 sasia është konvertuar nga një pako që duhet të ketë 50 maska, në një maskë, për të bërë më të lehtë krahasimin me llot 1.

Përmes kësaj kontrate, komuna dezinfektuesin 500 ml e ka blerë me çmim shumë më të lartë sesa autoritet tjera gjatë kësaj periudhe. Në dhjetor, kohën kur edhe është nënshkruar kontrata, çmimi i dezinfektuesit me sasi 500 ml në procedurat me negociim ka kushtuar rreth katër (4) euro, ndërsa në tenderët me procedurë të hapur, çmimi mesatar ka qenë 1.80 euro, ndërsa komuna e ka blerë pesë (5) euro, gjë që tregon se komuna ka paguar më shtrenjtë se

çmimi i tregut, gjë që ka dëmtuar buxhetin e saj. Përdorimi i procedurës emergjente i jep të drejtë komunës që të negociojë çmimin e ofertës, por as kjo nuk është bërë.

Si përfundim, Komuna e Gjakovës i ka bërë disa shkelje me lidhjen e kësaj kontrate: ka përdorur procedurën emergjente në një kohë kur pandemia nuk mund të cilësohet më emergjencë, ka shpallur fituese kompaninë që nuk ka licencë për tregtinë e produkteve mjekësore dhe nuk është siguruar që çmimi i kontratës nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

ShSKUK - Shërbime funerale me COVID-19

Është hera e parë që Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës ka hapur tenderë për shërbime funerale, për shkak të emergjencës që solli pandemia. Tenderin e parë të këtij lloji, ky institucion e ka lidhur në gusht të vitit 2020, e atë përmes procedurës së negociimit. Ftesës së ShSKUK-ut i ishin përgjigjur tre operatorë ekonomikë, Kosova Limo, V-SH Loti dhe N.T.P. Ngushëllimi, kjo e fundit kishte ofruar çmimin më të lirë prej 210,001 euro. Komuna ka ftuar të tri kompanitë në negociatë, mirëpo në negociatë ka marrë pjesë vetëm OE Kosova Limo e cila nuk kishte pranuar që të ulë çmimin¹⁰. Veprim pozitiv nga ShSKUK është se ka ftuar tri kompani për të dorëzuar ofertë, në kohën kur shumica e autoriteteve kontraktuese kanë ftuar nga vetëm një kompani.

ShSKUK nuk e ka ndërtuar si duhet paramasën ku ka përzier pozicionin ku ka dhënë sasinë indikative dhe një pozicion ku është dhënë sasia 1 km. Më poshtë është paraqitur paramasa së bashku me çmimet e dhëna nga N.T.P. Ngushëllimi:

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total
1	Përgatitja e trupave të vdekur për varrim nga COVID-19 dhe sëmundje të ngjashme.	Rast	500	€ 50	€ 25,000
2	Përgatitja e trupave të vdekur nga sëmundjet si ethet hemorragjike dhe të ngjashme	Rast	500	€ 50	€ 25,000
3	Arkivoli metalik i mbyllur hermetikisht	Copë	500	€ 150	€ 75,000
4	Arkivoli i drurit	Copë	500	€ 170	€ 85,000
5	Çmimi për kilometër për transportin e trupave të vdekur (kufomës) nga vendi ku ndodhet kufoma apo spitali deri në destinacionin e caktuar në tërë Kosovën.	Km	1	€ 1	€ 1
Totali i përgjithshëm me TVSh:					€ 210,001

TABELA 4 – Çmimet e kontratës të lidhur përmes procedurës së negociuar

Siç vërehet ShSKUK nuk ka përcaktuar sasi të çmimi për kilometër. Kjo është e kuptueshme pasi është e pamundur të dihet se sa kilometra do të ketë transport. Pikërisht për këtë është dashur të përdoret procedura me poentim të çmimit, e ku në paramasë për secilin pozicion

¹⁰ Procesverbali i negociatave me datë 07.08.2020.

sasia do të ishte 1 dhe secili pozicion do të peshohej në bazë të përqindjeve që do t'i kishte caktuar ShSKUK.

Kjo kontratë e lidhur për 12 muaj si kontratë kornizë ishte vazhduar jashtëligjshëm nga ShSKUK, pasi që është bërë porosi më tepër se që e lejon LPP, i cili e ndalon tejkalinin e vlerës totale të kontratës për më tepër se 30%¹¹. Nga faturat dhe pagesat që D+ i ka siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike, operatori ekonomik Ngushëllimi është paguar 399,116.60 euro, që gjë kapërcen 30% të tavanit të vlerës indikative të kontratës. Në këtë rast, ShSKUK ka pasur të drejtë të bëjë porosi deri në masën 273,001.30 euro. LPP¹² dhe RrUOPP e obligojnë autoritetin kontraktues, në këtë rast ShSKUK-un që ta ndërpres në mënyrë automatike kontratën¹³. Por, në këtë rast nuk është bërë një gjë e tillë. Me këtë tejkalinim, ShSKUK ka shpenzuar 126,115.30 euro më shumë sesa që i është lejuar me rregullin +30%.

Në katër fatura, N.T.P. Ngushëllimi ka faturuar ShSKUK, 370 euro për pozicionin “Përgatitja e kufomës me materiale mbështjellëse dhe me arkivol”. Mirëpo në kontratë nuk ka asnjë pozicion që ka këtë çmim. Nëse merret parasysh që kompania ka bërë bashkë dy pozicione (1 dhe 4) çmimi do të ishte 220 euro, aq sa ka faturuar kompania në katër fatura tjera. ShSKUK nuk ka verifikuar këtë siç duket e prandaj ka një tejkalinim aq të madh të vlerës së kontratës. 612 herë është porositur shërbimi që është faturuar 370 euro, ndërsa 621 herë ai me çmim 220 euro.

Pagesa prej 370 euro në vend të 220 eurove i ka shkaktuar humbje buxhetit të ShSKUK në vlerë prej 91,780 euro:

$$370 * 612 = 226,420 \text{ euro}$$

$$220 * 612 = 134,640 \text{ euro}$$

$$226,420 - 134,640 = 91,780 \text{ euro}$$

Është e kuptueshme nevoja që ShSKUK ka pasur për këtë shërbim, mirëpo nuk mund të arsyetohet çmimi prej 370 eurosh, i cili si i vetëm ka tejkalar çmimin e kontratës (370 * 612). ShSKUK është dashur ta ndërpresë kontratën në momentin kur e ka parë që mund të tejkalohej devijimi i lejuar prej +30% dhe të lidhë një kontratë të re. Po të përdorej procedura me poentim, atëherë nuk do të vlente kriteri prej +30% dhe ShSKUK do të mund të shpenzonte aq sa ka paraparë mjete.

ShSKUK në fillim të dhjetorit 2020 ka publikuar tenderin e ri për të njëjtin shërbim, duke përdorur procedurën e hapur. Kontrata ishte lidhur më 5 mars 2021 me operatorin ekonomik Funerali Sh.P.K. me çmim 133,761 euro. Pra, ngjashëm si me kontratën e parë, kompania e kontraktuar nga ShSKUK ka pasur për obligim ta bëjë përgatitjen e trupave të vdekur për varrim nga COVID-19 dhe sëmundje të ngjashme në arkivole druri, si dhe bartjen e trupave nga vendi ku është ndodhur kufoma deri në destinacionin e caktuar.

¹¹ Nëse urdhër blerjet tejkalojnë **sasinë totale indikative** ose **vlerën totale indikative** të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

¹² Neni 38 i LPP-së.

¹³ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. Neni 56.

<https://dpl.us/rroopp>

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total
1	Përgatitja e trupave të vdekur për varrim nga COVID-19 dhe sëmundje të ngjashme në arkivol druri	Rast	700	€ 190	€ 133,000
2	Përgatitja e trupave të vdekur nga sëmundjet si ethet hemorragjike dhe të ngjashme në arkivol druri	Rast	4	€ 190	€ 760
3	Çmimi për kilometër për transportin e trupave të vdekur, (kufomës) nga vendi ku ndodhet kufoma apo spitali deri në destinacionin e caktuar në tërë Kosovën.	Km	1	€ 1	€ 1
Totali i përgjithshëm me TVSh:					€ 133,761

TABELA 5 – Çmimet e kontratës të lidhura përmes procedurës së hapur

Nga paramasa mund të vërehet se çmimi i kontraktuar në procedurë të hapur (190 euro) është më i ulët se ai në procedurë të negociuar (220 euro). Pikërisht kjo dëshmi vërteton që ku ka konkurrencë të hapur çmimi i kontraktuar ka shumë gjasa që të jetë më i ulët. Dallimi prej 30 eurosh kur të llogaritet si total nëse merret parasysh sasia e kërkuar në kontratën e lidhur me procedurë të hapur është:

$$30 * 700 = 21,000 \text{ euro}$$

Njëjtë si në kontratën e kaluar ShSKUK ka përzier dy lloje të kontratës në një, procedurën e kontratës kornizë dhe të asaj me poentim të çmimit e që në fakt nuk është poentuar çmimi. Për shembull sipas kontratës së lidhur çmimi nuk guxon të kalojë +30% për secilin pozicion sipas RrUOPP, mirëpo vërehet që pozicioni 3 që është për transport është tejkualuar disa herë. Pasi në këtë pozicion sasia e dhënë është 1km, atëherë tejkualimi për 30% do ta rriste sasinë në 1.3km e cila është e pamjaftueshme për të ekzekutuar kontratën. Si rezultat i tejkualimit të këtij pozicioni për më tepër se 1.3km, kontrata duhet të ndërpritet në mënyrë automatike.

Komuna e Drenasit - Furnizim me pako emergjente për nevojtarë - (611-20-1015-1-2-5)

Duke parë situatën e vështirë që kishte sjellë pandemia, veçanërisht te familjet në nevojë, Komuna e Drenasit ka inicuar procedurën e negociuar pa publikim të kontratës për përmbushje të këtij qëllimi. Kjo procedurë ka qenë e nxitur të përdoret nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP), për shkak të gjendjes së vështirë me pandeminë. RrUOPP¹⁴ parasheh që në procedura të tilla të negociuara operatorët ekonomikë

¹⁴ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. Neni 52.
<https://dpl.us/rroupp>

ftohen nga autoriteti kontraktues dhe të njëjtit mund të dorëzojnë ofertat e tyre për tenderin konkret.

Për këtë aktivitet të prokurimit, vlera e parashikuar ishte 30,000 euro. Komuna ka ftuar pesë OE të ofertojnë, ndërsa ofertë kanë dorëzuar vetëm tre prej tyre (Hajdini Comerc, ATC Sh.P.K dhe Jora Center). Operatori ekonomik fitues i këtij tenderi ishte ATC Sh.P.K me çmim 30,000 euro. Komuna këtë procedurë e ka bërë duke anashkaluar platformën e-Prokurimi, prandaj në procesverbalin e hapjes së ofertave është listuar vetëm oferta e ATC Sh.P.K. Komuna është dashur që ftesat për ofertë dhe dosjen e tenderit së bashku me paramasë t’ua dërgojë të pesë kompanive që i ka ftuar dhe pastaj ofertat e tyre të vijnë përmes e-Prokurimit.

Komuna ka përdorur procedurën me çmim për njësi ku 18 produkte të ndryshme i ka vendosur së bashku dhe të cilat formojnë një pako. Hajdini Comerc kishte dorëzuar ofertën me çmim 59 euro për pako me 19 artikuj ushqimor dhe higjienik, ndërsa AK ka njoftuar operatorin se oferta është e shtrenjtë dhe operatorët e tjerë kanë ofertuar me çmime më të ulëta. Jora Center kishte ofertuar me çmimin 43.99 euro për pako, çmim i cili është nën vlerën e parashikuar, por që edhe për këtë ofertë AK ka ardhur në përfundim se kanë oferta më të lira. Kjo ofertë është më e lirë sepse për një produkt ka vendosur çmimin 0 euro pasi sipas tyre nuk e kanë atë produkt. Megjithatë sipas RrUOPP,¹⁵ ofertat me çmim 0 euro, duhet të eliminohen. Oferta tjetër e dorëzuar është e ATC Sh.P.K., me çmimin 54.25 për pako.

OE ofertues	Çmimi për pako para negocimit (në euro)	Çmimi për pako pas negocimit (në euro)	Total (në euro)
ATC Sh.P.K	54.25	50	30,000
Jora Center Sh.P.K	43.99*	/	26,394
Hajdini Commerc	59	/	35,400

TABELA 6 – Çmimet para dhe pas negocimit

AK ka zhvilluar negociata vetëm me ATC Sh.P.K., pas së cilave është arritur një marrëveshje për zbritje të çmimit. Fillimisht, çmimi i ofruar për pako ishte 54.25 euro ose në vlerë totale 32,550 euro, ndërsa pas negocimit çmimi për pako ishte ulur në 50 euro apo në total 30,000 euro.

Por, po të analizohet mirë oferta e dhënë nga operatori në fjalë, shohim se janë zbritur disa çmime në artikuj dhe një artikull është eliminuar në total, pra një artikull nuk figuron më në paramasë. Ky ndryshim nuk është evidentuar në procesverbalin e negociatave që komuna ka zhvilluar me ATC Sh.P.K. Pikërisht këtu lind problemi me mënyrën si ka vepruar komuna. Pra komuna ka pranuar oferta nga dy kompani tjera duke anashkaluar e-Prokurimin dhe duke mos i dhënë mundësinë që ato të ofertojnë zyrtarisht. Përderisa komuna ka refuzuar ofertën e Hajdini Comerc me arsyen se ka çmim të shtrenjtë, por i cili në paramasë ka pasur 19 artikuj, ka zhvilluar negociatat vetëm me ATC Sh.P.K. e cila në kontratë ka 18 artikuj për një pako.

Artikulli i larguar është artikulli i dytë më i shtrenjtë në paramasën e ofruar dhe vlera e tij ka bërë diferencë dhe ka përcaktuar fituesin e kontratës. Më konkretisht, artikulli “Çaj 1 kg” është ofruar me çmim 5 euro nga Hajdini Comerc, nga Jora Center me çmim 5.9 euro dhe ATC Sh.P.K me 4.49 euro. Vlerat në çmime që ka ulur OE ATC Sh.P.K janë në artikullin 5 ku ka zbritur vlerën nga 2.8 euro në 2.5 euro, artikullin shampon për enë 500ml nga 0.9 euro është zbritur vlera në 0.7 euro, në artikullin 15 (biber i kuq 100gr) nga 0.42 në 0.4 dhe në

¹⁵ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. Neni 41.15.
<https://dpl.us/rruopp>

artikullin 19 (mish i ngrirë konzervë 200gr) nga 11 në 10.86 euro. Në total kjo zbritje është vetëm 0.66 euro. Duke e hequr artikullin “Çaj 1kg” nga paramasa që ka çmimin 4.49 euro, gjë që ka bërë që çmimi për pako të jetë 50 euro. Nga kjo kuptohet se çmimi në fakt është zbritur për vetëm 0.66 euro dhe jo për 5.15 euro. OE nuk ka zbritur çmimin për produkte, por ka ndryshuar paramasën duke eliminuar një pozicion në tërësi, eliminimi i të cilit i ka mundësuar që të jetë OE më i lirë dhe të shpërblehet me kontratë. Duke qenë se ndryshimi i paramasës nuk ka asnjë bazë ligjore, në këtë rast AK ka dështuar të kryejë procedurën e negocimit në përputhje me ligjin.

Artikulli	Çmimi para negocimit	Çmimi pas negocimit
Detergjent 3kg	2.80	2.50
Shampon 500ml	0.90	0.70
Biber i kuq 100gr	0.42	0.40
Miell tip 400	11	10.86
Qaj 1kg	4.49	00.0*

*artikulli është fshirë nga paramasa

TABELA 7 – Çmimet para dhe pas negocimit për disa produkte

Në këtë rast, AK ka trajtuar OE të tjerë në mënyrë të pabarabartë pasi sikur të ftoheshin edhe ata në negociata dhe ta dinin që artikulli “Çaj 1kg” do të hiqej nga paramasa atëherë oferta e tyre do të ishte më e lirë. Komuna në mënyrë arbitrare ka vendosur se ofertat tjera janë më të shtrenjta pa ju dhënë mundësi që të negociohet çmimi.

D+ ka analizuar edhe dy tenderë të ngjashëm të të njëjtës komunë, të cilat janë paraqitur më poshtë.

Komuna e Drenasit - Furnizim me pako emergjente për nevojtarë (611-20-1367-1-2-5)

Ky tender është lidhur në mes të muajit prill të vitit 2020, menjëherë pas tenderit të parë të lidhur në muajin mars dhe përsëri është zhvilluar përmes procedurës së negociuar.

Për këtë aktivitet të prokurimit, Komuna e Drenasit ka ftuar për të dorëzuar ofertë Elkos Sh.P.K., N.T.P. Hajdini, Viva Fresh Store, Demaku B.I, Shqipdoni Sh.P.K, dhe ATC Sh.P.K. Për dallim nga tenderi i parë, tani komuna ftesat për ofertë i ka dërguar përmes e-Prokurimit dhe të gjithë ofertat e pranuar janë paraqitur në procesverbalin e hapjes së tenderëve.

Oferta për këtë tender kanë dorëzuar vetëm tre operatorë ekonomikë, ndërsa fitues u zgjodh ATC Sh.P.K me çmim 85,000 euro.

OE ofertues	Çmimi për pako para negocimit (në euro)	Çmimi për pako pas negocimit (në euro)	Total (në euro)
ATC Sh.P.K	42.65	42.50	85,000
Demaku B.I	42.99	/	85,980
Hajdini Commerc	43.75	/	87,500

TABELA 8 – Çmimet para dhe pas negocimit

Përderisa në tenderin e parë komuna ka paraparë fillimisht 19 artikuj për pako dhe pastaj është hequr një artikull, në tenderin e dytë ka paraparë 18 artikuj për pako e ku në tërësi janë kërkuar 2,000 pako. Në pako përfshihen ndër të tjera: vaj, miell, krip, qumësht, makarona, fasule, oriz, mëlmesa, mish, shampon për duar, enë dhe pastrim të ambienteve shtëpiake.

Dy nga operatorët ekonomikë kanë ofertuar me çmim total për 2,000 pakot, ndërsa një OE ka ofertuar me çmimin për një pako. OE Demaku ka ofertuar me çmim në vlerë prej 42.99 euro. Hajdini Comerc ka ofertuar me çmim 87,500 euro, e ku për një pako i bie të jetë çmimi 43.75 euro. Ndërsa, ATC ka ofertuar me çmim 85,000 euro, që për një pako të vetme çmimi është 42.50 euro.

Fillimisht, ATC për këtë aktivitet ka ofertuar me çmimin 42.65 euro për pako. Në bazë të procesverbalit të negociatave, i cili gjendet i publikuar në e-prokurim, komuna dhe kompania në fjalë kanë arritur që ta ulin çmimin në 42.50 euro për pako. Në total nga ky negociim, autoriteti kontraktues ka kursyer 300 euro nga buxheti. Mirëpo, përsëri komuna ka bërë trajtim jo të barabartë të OE-ve tjera pasi nuk i ka ftuar fare në negociata. Për shkak që çmimet për një pako janë të përafërta, komuna është dashur të ftojë në negociata të gjithë OE që kanë dorëzuar ofertë.

Në dhjetor 2020, Komuna e Drenasit kishte lidhur edhe një kontratë tjetër me procedurë të negociuar me të njëjtin operator ekonomik, për të njëjtin tender. Meqenëse kontrata është lidhur në dhjetor, ky autoritet kontraktues është dashur të përdorë procedurën e hapur, për të rritur konkurrencën pasi në këtë periudhë pandemia nuk mund të konsiderohet më emergjencë ekstreme. Kësaj here, komuna ka ftuar për të ofertuar vetëm kompaninë ATC Sh.P.K. Me këtë veprim janë diskriminuar të gjithë operatorët tjerë ekonomikë, duke ju pamundësuar që të marrin pjesë në këtë aktivitet.

Përderisa në dy tenderët e parë komuna nuk kishte aplikuar fare kritere, në këtë tender është kërkuar që OE-të të dorëzojnë referenca për furnizime të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit me një vlerë prej 50,000 euro.

ATC Sh.P.K. ka ofertuar me 43.38 euro për pako. Si i vetmi operator pjesëmarrës në këtë tender, i njëjti ishte ftuar që të marrë pjesë në negociata, gjatë së cilave çmimi ishte ulur në 42 euro për pako. Vlera e parashikuar për këtë kontratë ishte 91,155 euro, ndërsa totali i çmimit të kontratës së ofruar nga ATC Sh.P.K. ishte 89,040 euro.

Komuna e Istogut – Furnizimi me pako ushqimore dhe higjienike për familje skamnore

Edhe Komuna e Istogut ka përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Procedura për këtë tender ka filluar në prill të vitit 2020, me vlerë të parashikuar prej 50,000 eurove. Janë ftuar për të ofertuar tre operatorë ekonomikë me çmime të ndryshme për pako.

Për këtë tender kanë ofertuar Banana S.H Sh.P.K. me çmimin prej 26 euro për pako, N.T. Deni me çmimin prej 23.60 eurove dhe N.T.Sh. Jaffa me çmimin prej 24.47 euro për pako. Si çështje për negociim kanë qenë çmimi optimal më i lirë, transporti i pakos deri në vendet adekuate të përcaktuara dhe ruajtja dhe magazinimi i pakove. Mirëpo, kriteri për ruajtje dhe magazinim nuk është paraqitur në dosje të tenderit.

Të tri kompanitë janë ftuar në negociata, veprimi i cili ka qenë i duhur nga ana e komunës, krahasuar me atë të Drenasit.

OE ofertues	Çmimi para negocimit (në euro)	Çmimi pas negocimit (në euro)
Banana Sh.P.K.	26	25
Deni Sh.P.K.	23.60	25
Jaffa Sh.P.K.	24.47	26.47* ¹⁶

TABELA 9 – Çmimet para dhe pas negocimit

Banana Sh.P.K., si operator fitues të tenderit, fillimisht ofertoj 26 euro për pako, ndërsa me negocimin e çmimit e zbriti në 25 euro, që totali i kësaj oferte ishte 48,205 euro, që sipas llogaritjeve të komunës, ishte e vetmja kompani e cila ishte nën vlerën e parashikuar dhe më e përshtatshme për këtë aktivitet të prokurimit dhe e njëjta edhe është shpërblyer me këtë tender.

OE Deni kishte ofertuar me 23.60 euro për njësi, por gjatë procesit të negociatave, i njëjti kishte rritur çmimin e ofertës së saj në 25 euro me arsyen se për artikullin 10 që është detergjent për rroba, ka gabuar gjatë ofertimit pasi ka menduar që çmimi duhej dhënë për një kilogram detergjent e jo për tre. Çmimi është ndryshuar nga 1.10 euro për kg në 2.50 euro për të gjithë thesin e detergjentit. Gjithashtu, gjatë negocimit ndryshim të çmimeve në ofertë ka bërë edhe OE Banana. Kjo kompani ka zbritur çmimin për artikullin miell tip 400. Ky artikull kishte çmimin 11.50 euro për një thes me 25 kg miell, pas negocimit çmimi zbriti në 10.50 euro, e që në total çmimi për një pako është zbritur në 25 euro.

N.T.Sh. Jaffa është ftuar për negociata, por e njëjta nuk ka shfaqur interesim për ulje të çmimi, pra edhe pas negociatave çmimi kishte mbetur 26.47 euro. Mirëpo, në procesverbalin e hapjes së ofertave çmimi i OE Jaffa është 24.47 euro. Ky çmimi i njëjtë është edhe në ofertën e parë që ka dorëzuar. Rritja për dy euro për pako është bërë në ofertën e dytë që OE Jaffa ka dorëzuar. Siç duket ky OE e ka kuptuar që ka gabuar te çmimi për detergjent njëjtë si OE Deni. Çmimi është rritur nga një euro në tre euro për këtë artikull e që ka bërë që çmimi për pako të rritet nga 24.47 në 26.47 euro. Mirëpo ky ndryshim i çmimit nuk është evidentuar askund. Komuna në pyetjet që ka dërguar D+ është përgjigjur se OE Jaffa nuk është shprehur e gatshme për të ulur çmimin. Mirëpo vetë ekzistimi i dy paramasave lë të kuptohet se çmimi është rritur. Por kjo rritje nuk është evidentuar askund dhe sipas njoftimit mbi vendimin e autoriteti kontraktues, çmimi ka mbetur 24.47 euro dhe në letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm është cekur që oferta e Jaffa është 24.47, që është më e ulët se vlera e Banana Sh.P.K. që ka çmimin 25 euro.

Komuna ka bërë disa gabime gjatë procesit të këtij aktiviteti të prokurimit. Fillimisht për dosjen e tenderit e ka përdorur dokumentin e gabuar. Ka përdorur dosjen e tenderit për punë, në vend të asaj për furnizim. Në dosje nuk ceket që kontrata do të lidhet përmes kontratës kornizë, por kontrata e nënshkruar thotë që është kontratë kornizë. Ky lloj i kontratës ia mundëson komunës që të bëjë porosi deri në plus/minus 30% të sasive të dhëna. Komuna në paramasë ka dhënë sasi të përafërta, mirëpo në kontratë ka vendosur nene që kanë të bëjnë

¹⁶ OE Jaffa ka paramasën tjetër të ofertuar me çmim 24.47 euro, por që e njëjta nuk është evidentuar në procesverbal të negociatave, por është paraqitur si ofertë në njoftimin për vendim të AK-së, e cila gjendet në e-prokurim.

kur nuk dihen sasi të dhënë dhe përdoret çmimi për njësi apo i peshuar. Prandaj komuna edhe pse ka tejkalluar totalin e kontratës për 1,791.49 euro, kjo është në përputhje me LPP.

Një gabim tjetër është dorëzimi i çmimit në pako, përkundër dhënies së sasive të përafërta për secilin artikull. Ofertat është dashur që të dorëzohen me çmimin total duke shumëzuar sasinë me çmimin për njësi. Gjatë ekzekutimit të kontratës, shpërndarja e artikujve nuk është bërë sipas kategorizimit në pako, por janë shpërndarë duke bërë kategorizimin e familjeve në tre grupe. Këto grupe komuna i ka ndarë në bazë të anëtarëve të një familje. Grupi i parë ka përfshirë familjet me një deri në tre anëtarë për të cilët është destinuar pako e vogël, pastaj grupi i dytë me katër deri në gjashtë anëtarë për të cilët është destinuar pakoja e mesme dhe pakoja e madhe për familjet me më shumë se shtatë anëtarë. Për secilën kategori është përcaktuar çmimi duke marrë çmimet e kontratës.

Si përfundim, në këtë tender është bërë një përzjerje e disa procedurave të prokurimit në një tender. Kjo mund t'i shkaktojë probleme në të ardhmen, prandaj duhet të sigurohet që të përdoret procedura e duhur, pavarësisht a është gjendje emergjente apo jo.

Komuna e Prishtinës - Furnizimi me pako emergjente (ushqimore dhe higjienike) për familjet me kushte të vështirësuara ekonomike si rezultat i pandemisë COVID-19

Procedura për këtë tender është iniciuar në dhjetor të viti 2020 dhe vlera e parashikuar ka qenë 250,000 euro. Edhe në këtë tender është përdorur procedura e negociuar, mirëpo është dashur të përdoret procedura e hapur duke marrë parasysh që në dhjetor 2020 pandemia nuk mund të cilësohet më si emergjencë ekstreme. Megjithatë, komuna ka ndarë tenderin në pesë (5) lloje, ku për secilin lloj është dedikuar shuma prej 50,000 eurove. Paramasa për secilin lloj ka përfshirë të njëjta produkte, ato me artikuj ushqimor dhe material mbrojtës nga COVID-19.

Megjithatë, Komuna e Prishtinës ka ftuar gjashtë (6) operatorë ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Nga kompanitë e ftuara Viva Fly Sh.P.K., Albi Shopping Sh.P.K., Meridian Express, New Line Sh.P.K., Prex Sh.P.K. dhe New Vision Sh.P.K., vetëm katër prej tyre kanë dorëzuar ofertat e tyre. Komuna në dosje të tenderit ka përcaktuar që OE-të mund të ofertojnë për të gjitha llojet, por mund ta fitojnë vetëm një lloj. Kjo lejohet sipas RrUOPP-së¹⁷, mirëpo gabimi i komunës është që ka ftuar gjashtë kompani për të fituar nga një lloj. Në pamje të parë duket se komuna ka ftuar mjaftueshëm OE për t'u siguruar që ka konkurrencë, mirëpo vërehet që këtu nuk ka pasur mundësi për konkurrencë, pavarësisht se OE e ftuar nuk e kanë ditur se sa OE janë ftuar për të ofertuar. Gabim tjetër është ndarja e tenderit në lloje e ku artikujt për secilin lloj janë të njëjtë. Ky kriter do të mund të arsyetohej kur ka lloje me artikuj të ndryshëm të cilat nuk mund të ofrohen vetëm nga një kompani. Për shembull, artikujt ushqimor do të mund të ndaheshin në një lloj, ndërsa në një tjetër artikujt me material mbrojtës.

Siç u cek dhe më lartë, pas dërgimit të ftesave tek operatorët ekonomikë, vetëm katër prej tyre kishin dërguar ofertat e tyre. Të gjithë operatorët kanë ofertuar në të katër llojet me çmimet si në vijim: OE Viva Fly 46,970 euro, Albi Shopping 39,970 euro, New Vision & DPT Genc, 49,350 euro dhe OE New Line me 48,850 euro.

¹⁷ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. Neni 19.
<https://dpl.us/rruopp>

Meqenëse kjo ka qenë procedurë e negociuar, operatorët janë ftuar për negociata, ku disa prej tyre kanë pranuar që të bëjnë ndryshime të çmimeve për ofertat e dhëna. Viva Fly ka zbritur çmimin për 500 euro apo 0.50 euro për pako. Grupi i operatorëve ekonomikë New Vision & D.P.T Genc kanë zbritur çmimin për 500 euro apo 0.5 cent për pako dhe New Line ka zbritur çmimin për 600 euro apo 0.60 euro për pako. Albi Shopping nuk ka negociuar çmimin, duke vazhduar me ofertën 39,970 euro. Nga të gjitha negociatat e bëra, Komuna e Prishtinës ka arritur që të kursej 1,600 euro nga buxheti i saj.

Operatori ekonomik	Çmimi i parashikuar për llot (në euro)	Çmimi i ofertës fituese (në euro)	Çmimi pas negocimit (në euro)	Vlera e zbritur (në euro)
Viva Fly Sh.P.K. – Llot 1	50,000	46,970	46,470	500
Albi Shopping Sh.P.K. – Llot 2	50,000	39,970	39,970	/
Albi Shopping Sh.P.K. – Llot 3	50,000	39,970	39,970	/
G.O New Vision Sh.P.K. & DPT Genc – Llot 4	50,000	49,350	48,850	500
New Line Sh.P.K. – Llot 5	50,000	48,850	48,250	600

TABELA 10 – Çmimet para dhe pas negocimit dhe vlera e zbritur

Pasi për pesë llotet e ndara kanë ofertuar vetëm katër kompani, që imponohet rrethana e shpërblimit me dy lloje të njëjtin operator ekonomik, ku edhe RrUOPP¹⁸ parasheh situatën ku operatori ekonomik mund të shpërblehet me më shumë lloje se sa numri maksimal i llojeve, i destinuar për një operator ekonomik. Komuna, kontratën për llotin e parë e ka nënshkruar me Viva Fly Sh.P.K. me vlerë 46,470 euro. Kontratën për llot 2 dhe 3 e ka nënshkruar me Albi Shopping Sh.P.K. në vlerë prej 39.970 për një llot. Kontratën për llot 4 e ka lidhur me grupin e operatorëve ekonomikë New Vision & DPT Genc në vlerë prej 48,850 euro dhe kontratën për llot 5 e ka nënshkruar me Ne Line Sh.P.K. në vlerë prej 48,250 euro.

Përderisa aktiviteti ishte ndarë në lloje, autoriteti kontraktues nuk ka pasur zgjidhje tjetër, e në mungesë të konkurrenteve të tjerë ka shpërblyer me dy lloje operatorin ekonomik me çmimin më të ulët. Përderisa komuna e ka ditur që nuk mund të pranojë më shumë se gjashtë oferta, atëherë nuk është dashur që të kufizojë numrin e llojeve që mund ta fitonte një OE. Me këtë veprim komuna i ka shkaktuar dëm buxhetit të saj pasi ka mundur që të mos kufizojë numrin e llojeve dhe kontrata do të lidhej me çmim më të lirë.

Meqenëse operatorët ekonomikë e kanë ditur paraprakisht se pesë llotet do u ndaheshin kompanive të ndryshme, të njëjtit e kanë parë si mundësi që të lëvizin me çmime, ku madje edhe pas negocimit të çmimeve ka pasur dallime të mëdha ndërmjet ofertave. Në këtë rast, nëse komuna nuk do kishte përcaktuar ndarje heterogjene të llojeve, atëherë do të kishte oferta me çmime më të përafërta, e me siguri nuk do të kishte diferencë kaq të madhe në çmime.

¹⁸ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. Neni 19. <https://dpl.us/rruopp>

Llot	Çmimet e kontratës	Çmimi po të mos kufizohej numri i lloteve
1	46,470	39,970
2	39,970	39,970
3	39,970	39,970
4	48,850	39,970
5	48,250	39,970
Totali	223,510 euro	199,850 euro

TABELA 11 – Çmimet e kontratës aktuale dhe çmimet po të mos kufizohej numri i lloteve

Totali për të pesë llotet është 223,510 euro. Mirëpo, nëse Komuna e Prishtinës nuk do e kishte ndarë tenderin në lloje ose mos ta kishte vendosur kriterin që për një llot të shpërblehet vetëm një operator ekonomik, do të kursente shumë më shumë sesa shuma që është zbritur përmes negocimit. E njëjta do të mund të kursente nëse nuk do e kishte ndarë aktivitetin e prokurimit në lloje homogjene, pra kur autoriteti kontraktues shpërblen një kompani për të gjitha llotet ku është më e lira. Kjo gjë do ua pamundësonte kompanive konkurruese përcaktimin e lartë të çmimeve, e që ndërmjet ofertuesve të ketë dallime kaq të mëdha për të njëjtin artikull dhe të njëjtën sasi. Po të përdorej opsioni që mos të kufizohej numri i lloteve që mund të fitonte një OE, atëherë të gjitha llotet do t'i fitonte OE me çmimin më të lirë, e cila kishte ofertuar në total me 39,970 euro. Totali i kontratës do të ishte 199,850 euro, apo 23,660 euro më lirë se kontrata aktuale. Për shkak të përdorimit të një procedure të gabuar për këtë aktivitet të prokurimit, Komuna e Prishtinës ka dëmtuar buxhetin e saj për 23,660 euro.

Komuna e Vitisë - Furnizimi me material mbrojtës kundër COVID-19. Maska dhe dezinfektues

Komuna e Vitisë në dhjetor të vitit 2020 kishte lidhur kontratë furnizimi me Krasniqi Sh.P.K., e cila kishte për qëllim furnizimin me material mbrojtës kundër COVID-19, përkatësisht maska dhe dezinfektues. Vlera e parashikuar e kësaj procedure të prokurimit ishte 56,000 euro, përderisa kontrata e nënshkruar me OE ka qenë 55,963.20 euro apo vetëm 37 euro më pak se vlera e parashikuar.

Duke injoruar faktin se këtë tender mund ta realizonin edhe shumë operatorë tjerë ekonomikë, në këtë procedurë Komuna e Vitisë ka ftuar vetëm një kompani, veprim i cili dëmton konkurrencën ndërmjet operatorëve, por edhe humbet mundësia për të marrë oferta të ndryshme nga të cilat nuk përjashtohet fakti se mund të ishin edhe më të lira. Duke marrë parasysh që kontrata është lidhur në dhjetor 2020, nuk mund të arsyetohet përdorimi i kësaj procedure pasi pandemia COVID-19 nuk është më emergjencë ekstreme.

Megjithatë, duket se në këtë procedurë përveç që është ftuar vetëm një kompani nuk janë mbajtur as negociatat. Për këtë çështje, D+ ka kontaktuar me personin kompetent nga autoriteti kontraktues, nëse ka procesverbal të negociatave, por që i njëjti ka pohuar se një dokument të tillë nuk e kanë.

Komuna në fjalë, nëse do të kishte zhvilluar negociata, mund të nxiste uljen e çmimit, duke u bazuar edhe në çmimet në kontratat e tjera që janë lidhur në të njëjtën periudhë kohore.

D+ ka analizuar kontrata të ngjashme të lidhura gjatë kësaj periudhe në mënyrë që të krahasohen çmimet e dhëna nga OE Krasniqi Sh.P.K. Në kontratën e lidhur përmes

procedurës së hapur ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe OE Teknika Sh.P.K. me numër të prokurimit 328-20-7292-1-2-1, në fund të muajit nëntor përmes procedurës së hapur, mund të vërehen ndryshime në çmime të artikujve të njëjtë edhe pse dy kontratat janë lidhur në periudha pothuajse të njëjta. Në kontratën ndërmjet KGJK-së dhe Teknika Sh.P.K. ka artikuj të njëjtë krahasuar me kontratën e lidhur nga Komuna e Vitisë. Në kontratën e KGJK-së, për artikullin dezinfektues për duar 500 ml, çmimi është 1.70 euro për një copë, ndërsa, Komuna e Vitisë për të njëjtin artikull ka paguar 2.57 euro. Kjo tregon që çmimet në kontratat e lidhura përmes procedurës së hapur gjithmonë janë më të ulëta. D+ ka analizuar disa kontrata të periudhës nëntor – dhjetor 2020 dhe ka gjetur se dezinfektues 500 ml në kontratat e lidhura me procedurë të hapur çmimi mesatar ka qenë 1.87 euro, ndërsa në kontratat me procedurë të negociuar 3.94 euro.

Komuna e Vitisë po të përdorte procedurën e hapur me shumë gjasë kontratën do ta lidhte me çmime shumë më të volitshme, duke marrë parasysh të gjitha të dhënat që D+ i ka publikuar lidhur me çmimet e artikujve në kontratat me procedurë të hapur, të cilat kanë dëshmuar që janë dy deri tri herë më të ulëta.

Rekomandime:

Të përgjithshme:

- AK-të duhet të evitojnë shfrytëzimin e procedurave me negociim pa publikim të njoftimit për kontratë në rastet kur nuk ka natyrë emergjente, sepse do të kufizojë konkurrencën, e cila është një nga parimet e prokurimit publik. Pa konkurrencë, ka gjasa të mëdha që çmimet do të jenë më të larta. AK-të duhet që ta kenë parasysh këtë kur të vendosin të përdorin procedurën e negociuar.
- AK-të të ftojnë sa më shumë OE edhe nëse përdoret procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Kjo siguron që të ketë së paku konkurrencë minimale, edhe nëse përdoret procedura e negociuar. Ftesa për vetëm një kompani për të dorëzuar ofertë është kundër parimeve të prokurimit publik;
- Të ftohen të gjithë OE që kanë plotësuar kriteret në fazën e negociatave në mënyrë që në mes tjerash të negociohet çmimi. Ka gjasa të mëdha që kompanitë do ta ulin çmimin kur ato e dinë që disa ofertues janë ftuar për të negociuar;
- AK të sigurohet që mos të paguajë produktet më shumë se çmimi i tregut. AK-të duhet që të krahasojnë të gjitha çmimet e dhëna nga ofertuesi me çmimet e tregut;
- Të mos u bëhet ftesë për negociim disa grupe operatorësh ekonomikë së bashku. Ftesa për negociim u dërgohet operatorëve ekonomikë veç e veç, pasi vendimin për të ofertuar si konsorcium nuk e merr autoriteti kontraktues, por vetë operatorët ekonomikë;

Të veçanta:

- ShSKUK duhet që të sigurohet që mos ta tejkalojë vlerën e kontratës kornizë në mbi 30%;
- Komuna e Prishtinës të sigurohet që ta bëjë ndarjen në lloje kur fton një numër më të madh të OE-ve se sa numri i llojeve të parapara ose të përdorë procedurën e hapur;
- Komuna e Vushtrrisë të sigurohet që kontrata me vlerë të madhe të nënshkruhet edhe nga kryetari i komunës, në mënyrë që ato të jenë të zbatueshme.



**Funded by
the European Union**



**Democracy
Plus**